



N J O F T I M

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, shpall konkursin për 8 vende të reja pune për personel akademik me kohë të pjesëshme (Part-Time) në Fakultetin e Shkencave Politike-Juridike të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, sipas departamenteve të mëposhtme:

FAKULTETI I SHKENCAVE POLITIKE – JURIDIKE 8 VENDE:

- 1. Administrimit Publik 6 vende;**
- 2. Shkencave Politike 2 vende;**

A. Të interesuarit për vendet e mësipërme duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të ketë mbaruar studimet e Bachelor me mesatare mbi 8.
2. Të ketë mbaruar studimet pasuniversitare (Master të Nivelit të Dytë ose ekuivalentin e tij) në një nga drejtimet studimore të Shkencave Politike, me mesatare 9.
3. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
4. Të ketë eksperiencë pune të paktën 2 vjeçare.

B. Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e aplikimit për personel akademik i cili mund të shkarkohet në faqen e internetit të universitetit në adresën www.uamd.edu.al, ose të tërhiqet dorazi në zyrën e Degës së Burimeve Njerëzore të universitetit;
2. Tre letra rekomandimi nga pedagogë apo udhëheqës shkencor të kandidatit dhe të paktën një nga tre letrat të jetë nga punëdhënësi / drejtuesi i fundit nëse ka një të tillë;
3. Fotokopje të diplomës, të noterizuar;
4. Fotokopje të certifikatës së notave të noterizuar;
5. Fotokopje të dëshmimeve kualifikimi të ndryshme, të noterizuara;
6. Fotokopje të artikujve shkencorë të publikuar në revista ndërkombëtare profesionale / shkencore dhe / ose punime të tjera;
7. Fotokopje të pasaportës ose të një dokumenti identifikimi;
8. Të përgatitet një orë leksion i hapur.
9. Deklaratë nga kandidati aplikues për gjëndjen gjyqësore.

Diplomat, certifikatat, gradat dhe titujt e fituar në institucione të huaja arsimore, duhet të jenë të përkthyer dhe të shoqërohen me certifikatën e njehsimit, bazuar në Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38.

C. Afati i fundit i pritjes aplikimeve është deri në **31.12.2011**.

D. Të interesuarit duhet të dërgojnë me postë dokumentacionin përkatës, në adresën;

Universiteti “Aleksandër Mosiu”

Fakulteti: _____

Departamenti: _____

Lagja 1, Rruga e Currilave, Durrës.

E. *Nuk lejohet paraqitja e dokumentacionit dorazi.*

F. *Proçedura e përzgjedhjes së kandidaturave fillon menjëherë pas publikimit të këtij njoftimi dhe do të zhvillohet sipas Udhëzimit Nr. 129, datë 30.01.2009 “Për përzgjedhjen dhe rekrutimin e personelit akademik, ndihmës mësimesor – shkencor dhe administrativ, në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës.*